



Drejtoria e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim

ZYRA E TATIMIT NË PRONË

NJOFTIM PUBLIK

Afati i Pagesës së Tatimit në Pronë Nxjerrja e Faturës, dhe Mënyra e Pagesës

Të nderuar qytetarë,

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – Zyra e Tatimit në Pronë, njofton të gjithë tatimpaguesit se afati i fundit për pagesën e këstit të dytë të Tatimit në Pronë për vitin 2026 është data 30 shtator 2026.

Pas kësaj date, për të gjitha obligimet e papaguara do të aplikohen interesi dhe gjoba për vonesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për Tatimin në Pronë si në vijim:

- Në shumën e tatimit të secilit këst të pa paguar llogaritet një gjobë prej 10%.
- Në shumën e tatimit të secilit këst të pa paguar llogaritet interesi në baza mujore prej 0.65%.

Pagesa e Tatimit në Pronë mund të bëhet në:

- Në ndonjë nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- Përmes E-Banking.
- Përmes platformës eKosova.
- Në Postën e Kosovës apo institucione tjera të licencuara në Kosovë.
- **Kësti i dytë mund të paguhet deri me 30 Shtator 2026**

Komuna Klinë njofton tatimpaguesit që janë të regjistruar në sistemin e tatimit në pronë me numra personal të Republikës së Kosovës se mund të nxjerrin faturën e tatimit në pronë drejtpërdrejt në platformën e-KOSOVA në linkun <https://ekosova.rks-gov.net/> ose duke u paraqitur personalisht në komunën ku edhe janë pronarë/e ose posedues/e të pronës së paluajtshme

Drejtori i Financave, Ekonomi dhe Zhvillim

Faruk Smajli

